FLLADI I NJË MUAJI TË BEGATË

Udha e BESIMTARËVE

ÇFARË ËSHTË AGJËRIMI? 8

DISA NGA VEÇORITË E MUAJIT RAMAZAN 16

PO NËSE NUK E AGJËROJ MUAJIN E RAMAZANIT ? 22

SI FITOHET BEGATIA E RAMAZANIT ? 24

RREGULLAT E AGJËRIMIT 29

ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN ? 33

ÇFARË NUK E PRISH AGJËRIMIN ? 34

CILAT JANË KATEGORITË E PËRJASHTUARA NGA AGJËRIMI I RAMAZANIT ? 36

PËRCJELLJA E RAMAZANIT 39

MUAJI I RAMAZANIT, FTESË PËR PENDIM... 41

Përgatiti:

QENDRA KULTURORE FETARE "UDHA E BESIMTARËVE"

Boton:

QENDRA KULTURORE FETARE "UDHA E BESIMTARËVE"

Rr. Kajo Karafili, Pll. 8, Shk. 1, Ap. 12, Tiranë, Albania
Tel.: +35542247064, Mob.: +355693565505,
+355672567863
e-mail: info@udhaebesimtareve.com

www.udhaebesimtarëve.com

FLLADI I NJË MUAJI TË BEGATË

Vitet ikin dhe pasojnë njëri-tjetrin, e ashtu pa u ndjerë ikën dhe jeta e njeriut.

Duket sikur kanë kaluar vetëm disa ditë dhe jo një vit i plotë, dhe ja muaji i begatë i Ramazanit erdhi përsëri.

Lodhja, etja dhe uria që përjetuam Ramazanin e kaluar janë harruar, ndërsa shpërblimi tek Zoti i Madhëruar është depozituar.

Dëshira për ta arritur këtë muaj preokupon zemrat e besimtarëve. Ata luten që Allahu t`ua mundësojë agjërimin e muajit të Ramazanit.

Unë dhe ti jemi nga ata që Allahu na begatoi, na dha jetë, shëndet, forcë dhe e arritëm këtë muaj të begatë, të cilin me dëshirë e presim dhe me përkushtim e përjetojmë.

Muaji i Ramazanit është bukuria e vitit dhe një dhuratë e madhe nga Zoti i gjithësisë. Është thesari i njerëzve të devotshëm dhe periudha e begatë në të cilën pasurohen shpirtrat e besimtarëve.

Është muaji për të cilin na ka përgëzuar profeti Muhamed ﷺ duke thënë: **"Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e Zjarrit dhe prangosen djajtë."**

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Në vitin e dytë të hixhretit - pas emigrimit të Profetit ﷺ në Medine - Allahu i Madhëruar zbriti këtë ajet: **“O ju që keni besuar! Agjërimi u është bërë obligim, ashtu siç ishte obligim edhe për popujt para jush, me qëllim që të bëheni të devotshëm.”** (Kuran, El Bekare 183).

POR, ÇFARË ËSHTË AGJËRIMI?

"Agjërimi është: Privimi i vetvetes nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime, me qëllim adhurimi për Allahun, që nga fillimi i agimit e deri në perëndimin e diellit."

Pra, agjërimi është ai lloj adhurimi, në të cilin njeriu heq dorë përkohësisht nga disa prej kënaqësive të kësaj bote, e këtë e bën për hir të Allahut të Madhëruar, për të fituar kënaqësinë e Tij dhe për ta depozituar shpërblimin për në Ditën kur do të takohet me Të (në botën tjetër).

Agjërimi, ndryshe nga adhurimet e tjera, i ka disa veçori specifike dhe dobi madhështore, ashtu siç do t'i përmendim në vijim:

-1-

AGJËRIMI ËSHTË ADHURIMI MË I VEÇANTË QË I KUSHTOHET ZOTIT

Allahu i Madhëruar, në një hadith kudsij, ka thënë: **"Çdo vepër e birit të Ademit është për të, me përjashtim të agjërimit, i cili është për Mua dhe Unë shpërblej për të".** (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Kurtubiu, dijetari i madh i tefsirit, ka thënë: "Të gjitha punët janë të dukshme, ndërsa agjërimi është vepër që nuk duket (nuk vërehet nga njerëzit), prandaj dhe Allahu e ka quajtur 'të veçantë' për Të."

- 2 -

AGJËRUESI SHPËRBLEHET PA MASË

Profeti ﷺ na ka treguar se Allahu i Madhëruar thotë: **“Robi Im e lë ngrënien, pirjen dhe kënaqësitë trupore për Mua. Agjërimi bëhet për Mua dhe Unë shpërblej për të. E mira tek Unë shpërblehet dhjetë deri në shtatëqind fish, përveç agjërimit, të cilin Unë e shpërblej pa masë.”**

(Transmeton Buhariu)

- 3 -

AGJËRUESI KA DY MOMENTE GËZIMI

Profeti ﷺ ka thënë: **“Agjëruesi ka dy momente gëzimi: Kur çel iftarin dhe kur ta takojë Zotin e tij.”**

(Transmeton Buhariu)

- 4 -

AGJËRUESIT KANË NJË PORTË TË VEÇANTË PËR HYRJEN NË XHENET

Profeti ﷺ ka thënë: **"Në Xhenet ka një portë që quhet Rejan, nëpërmjet së cilës futen agjëruesit në Ditën e Gjykimit, dhe askush tjetër përveç tyre nuk futet nga ajo portë.**

Atë ditë do të thuhet: 'Ku janë agjëruesit?' Ata do të futen brenda nëpërmjet asaj porte. Pasi të futet edhe agjëruesi i fundit, porta do të mbyllet dhe nuk do të futet më askush tjetër nga ajo portë."

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

-5-

AGJËRIMI ËSHTË MBUROJË

Agjërimi është mburojë për të mos rënë në gabime, fjalë dhe vepra të ndaluara, siç ka thënë Profeti ﷺ : **"Ai që nuk i lë fjalët e pavërteta dhe shtirjen, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai ta lërë ushqimin dhe pijen".** (Transmeton Buhariu) Gjithashtu, agjërimi është mburojë kundrejt ligësive të të tjerëve karshi teje.

Në lidhje me këtë, Profeti ﷺ ka thënë: **"Agjërimi është mburojë, prandaj kur ndonjëri nga ju agjëron, nuk duhet të flasë fjalë të pahijshme, e as të ngrejë zërin**

duke debatuar. Nëse dikush e sulmon ose e fyen, le t'i thotë: Unë jam me agjërim."

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

- 6 -

ALLAHU E DO ERËN E GOJËS SË AGJËRUESIT

Profeti ﷺ thotë: **"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, era e gojës së agjëruesit është më e dashur për Allahun sesa aroma e miskut (parfumit më të mirë)."**

(Transmeton Buhariu)

DISA NGA VEÇORITË E MUAJIT RAMAZAN

- 1 -

AGJËRIMI GJATË MUAJIT RAMAZAN, ËSHTË NJË NDËR PESË SHTYLLAT BAZË TË ISLAMIT.

Profeti ﷺ thotë: **"Islami ngrihet mbi pesë shtylla: Deklarimi se askush dhe asgjë nuk meriton të adhurohet përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i muajit Ramazan."**

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

- 2 -

RAMAZANI ËSHTË MUAJI NË TË CILIN KA ZBRITUR KURANI

Allahu i Madhëruar thotë: **"Në muajin e Ramazanit ka zbritur Kurani, i cili është udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues i saj nga rruga e shtrembër, prandaj, cilido që e arrin këtë muaj, le ta agjërojë atë."** (Kuran, El Bekare 185).

- 3 -

NË MUAJIN E RAMAZANIT HAPEN PORTAT E XHENETIT, MBYLLEN PORTAT E ZJARRIT DHE PRANGOSEN DJAJTË.

Profeti ﷺ ka thënë: **"Natën e parë të Ramazanit prangosen djajtë dhe xhinët më agresorë, mbyllen portat e Zjarrit duke mos mbetur e hapur asnjë portë e tij, hapen portat e Xhenetit duke mos mbetur e mbyllur asnjë portë e tij, dhe thërret një thirrës: 'O ti që e do të mirën, afrohu! O ti që e do të keqen, frenohu!' Allahu liron njerëz nga zjarri çdo natë të Ramazanit".**

(Transmeton Tirmidhiu, dhe e ka saktësuar Albani)

- 4 -

NË KËTË MUAJ GJENDET NATA E KADRIT, E CILA ËSHTË MË E VLEFSHME SE NJËMIJË MUAJ.

Ebu Hurejra tregon se Profeti ﷺ ka thënë: **"U ka ardhur Ramazani, muaji i begatë. Allahu ua ka obliguar agjërimin e këtij muaji. Në të hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe lidhen në pranga djajtë më agresorë.**

Allahu në këtë muaj ka bërë një natë, e cila është më e vlefshme se njëmijë muaj. Ai që privohet nga të mirat e kësaj nate, është privuar nga çdo e mirë".

(E transmeton Nesaiu. Hadithi është Sahih).

- 5 -

AGJËRIMI I RAMAZANIT BËHET SHKAK PËR FALJEN E GJYNAHEVE TË KALUARA.

Profeti ﷺ ka thënë: **"Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar shpërblimin, do t`i falen mëkatet që i ka bërë më herët."**

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

- 6 -

NË KËTË MUAJ PRANOHEN LUTJET DHE LIROHEN NJERËZ NGA ZJARRI

Profeti ﷺ ka thënë: **"Allahu për çdo ditë dhe natë (të Ramazanit) liron njerëz nga zjarri dhe çdonjëri prej tyre e ka një lutje të pranuar".**

(E transmeton Ahmedi. Hadithi është Sahih).

PO NËSE NUK E AGJËROJ MUAJIN E RAMAZANIT ?

Të mos e agjërosh muajin e Ramazanit, pa pasur ndonjë arsye e cila të pengon nga agjërimi, është mëkat i madh. Madje, kjo bëhet shkak për të qenë larg nga mëshira e Zotit të Madhëruar.

Ebu Hurejra tregon se Profeti ﷺ, pasi u ngjit një ditë në minber, tha: **'Amin!'.**

Kur e pyetën se përse veproi ashtu, u përgjigj: **"Më erdhi Xhibrili dhe më tha: "Kush e arrin muajin e Ramazanit dhe nuk e ka shfrytëzuar (si mundësi) që t`i falen gjynahet, Allahu e largoftë nga mëshira e Tij! Thuaj 'Amin!" Unë thashë: 'Amin!".**

Pra, muslimani jo vetëm që e ka obligim ta agjërojë këtë muaj të begatë, por duhet të përpiqet me të gjitha forcat që të përfitojë sa më shumë nga begatitë dhe mirësitë e tij, duke i shtuar adhurimet vullnetare dhe veprat e mira në tërësi.

SI FITOHET BEGATIA E RAMAZANIT ?

Ez-Zuhriu, dijetari i madh në kohën e tabi'inëve, thoshte: **"Ramazani është i karakterizuar nga leximi i Kuranit dhe bamirësia".**

Këto dy vepra kanë qenë praktikë e pandashme e Profetit ﷺ në Ramazan.

Ibën Abasi thoshte: **"I Dërguari i Allahut ﷺ ka qenë njeriu më bujar, dhe bujarinë më të madhe e shfaqte në Ramazan, muaj në të cilin takohej me Xhibrilin. Ai takohej me të çdo natë të Ramazanit, duke e studiuar me të Kuranin. Në Ramazan, i Dërguari i Allahut ishte më i shpejtë në bujari sesa era kur fryn".**

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Pra, përveç agjërimit, i cili është obligimi kryesor, Profeti ﷺ shtonte dhe dy vepra të tjera për të fituar mirësinë e këtij muaji:

a- Leximin e Kuranit, sepse Ramazani është muaji i Kuranit.

Ky lexim mund të bëhet në namaz, gjatë teravive, ose edhe jashtë namazit.

b- Bujarinë.

Këtë ai e shfaqte duke ushqyer të uriturit dhe nevojtarët, si dhe duke u dhënë sadaka (ndihmë financiare) të varfërve.

Ushqimi më i mirë që ofrohet gjatë muajit të Ramazanit është t'u shtrosh iftar agjëruesve.

Kjo, sepse Profeti ﷺ ka thënë: **“Kush i shtron iftar një agjëruesi, do ta ketë shpërblimin njësoj si ai, pa u pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit”.** (Transmeton imam Ahmedi. Albani e ka vlerësuar Sahih).

Kulmi i begatisë së Ramazanit gjendet në dhjetë netët e fundit të tij, kjo sepse midis atyre netëve gjendet Nata e Kadrit, e cila është e dalluar për shumë veçori, ndër të cilat përmendim:

1- Zbritja e Kuranit në këtë natë.

Argument për këtë, është fjala e Allahut të Madhëruar: **"Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) në Natën e Kadrit".** (Kuran, El Kadr 1).

2- Punët e mira në këtë natë shumëfishohen.

Kjo veçori është ndër shkaqet kryesore që e bëjnë atë natë më të vlefshme se njëmijë muaj, siç thotë Allahu në Kuran: **"Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj".** (Kuran, El Kadr 3).

3- Këtë natë zbresin engjëjt, dhe veçanërisht engjëlli Xhibril, siç thotë Allahu në Kuran: **"Në të zbresin engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili) me caktimin e çdo gjëje".** (Kuran, El Kadr 4).

4- Kush e kalon këtë natë duke u falur dhe duke adhuruar Zotin, i falen të gjitha gjynahet e kaluara, siç ka thënë Profeti ﷺ : **"Kush e përjeton natën e Kadrit me adhurim ndaj Zotit, me besim të sinqertë dhe duke shpresuar shpërblimin, do t`i falen mëkatet që i ka bërë më herët."**
(Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Për të arritur begatinë e kësaj nate, Profeti ﷺ i kalonte dhjetë ditët e fundit të Ramazanit i ngujuar në xhami (bënte itikaf), siç tregon Aisheja: **"Profeti ﷺ ka bërë itikaf dhjetëditëshin e fundit të çdo Ramazani, derisa ndërroi jetë".**
(Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

RREGULLAT E AGJËRIMIT

1- Nuk hahet, nuk pihet dhe nuk kryhen marrëdhënie seksuale nga agimi deri në perëndim të diellit.

Allahu i Madhëruar thotë: **"Hani dhe pini derisa të dallohet në horizont filli i bardhë (i agimit) nga filli i zi (terri i natës), pastaj plotësojeni agjërimin deri sa të hyjë nata".**

(Kuran, El Bekarah 187)

Siç kuptohet nga ky ajet kuranor, agjërimi ka dy kufij kohorë: shfaqjen e agimit dhe perëndimin e diellit, brenda të cilëve ndalohet ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime.

Ndërsa sa i përket marrëdhënieve intime (bashkëshortore), Allahu i Madhëruar thotë: **“Është lejuar për ju gjatë netëve të agjërimit që t’ju afroheni grave tuaja (për marrëdhënie intime)”** (Kuran, El Bekarah 187).

Pra, nga ky ajet kuranor kuptojmë se marrëdhëniet intime gjatë ditës nuk lejohen, sepse është koha e agjërimit.

2- Të bëhet nijeti (me zemër).

Pra, të vendosësh për të agjëruar, para se të ketë hyrë koha e agjërimit. Profeti ﷺ ka thënë: “**Kush nuk e vendos të agjërojë që me natë, agjërimi i tij nuk është i saktë”.**

(Transmeton Tirmidhiu dhe Nesaiu. Albani e ka vlerësuar Sahih)

3- Të hash syfyr. Profeti ﷺ ka thënë: **“Syfyri është ushqim i begatë, prandaj mos e lini atë, edhe sikur me një gllënjkë ujë, se Allahu i bekon ata që hanë syfyr ndërsa engjëjt luten për ta.”**

(Transmeton Ahmedi, dhe e ka saktësuar Albani).

Gjithashtu, Profeti ﷺ ka thënë: **“Ushqehuni në syfyr, sepse në të ka bereqet!”**

(Transmeton Ibën Hibani. Albani e ka konsideruar hasen)

Po ashtu, ka thënë: “**Bëni syfyr, qoftë edhe me një gllënjkë ujë!”**

(Transmeton Ebu Daudi dhe Tirmidhiu, dhe e ka saktësuar Albani)

4- Të bësh iftar menjëherë pas perëndimit (rënies së diskut të diellit), siç ka thënë Profeti ﷺ : **"Tri gjëra janë prej traditës profetike: Shpejtimi i iftarit, vonimi i syfyrit dhe vendosja e dorës së djathtë mbi dorën e majtë në namaz".** (Transmeton Taberaniu dhe e ka saktësuar Albani)

ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN ?

- Ngrënia dhe pirja me vetëdije.
- Përdorimi i ilaçeve apo injeksioneve ushqyese.
- Pirja e duhanit
- Përtypja e çamçakëzit.
- Transfuzioni i gjakut dhe dializa.
- Marrëdhëniet intime bashkëshortore në harkun kohor nga agimi deri në perëndimin e diellit.
- Vjellja e ushqimit në mënyrë të vullnetshme (me dashje).
- Shfaqja e periodave apo lehonisë tek femrat.

ÇFARË NUK E PRISH AGJËRIMIN ?

1- Ngrënia dhe pirja nga harresa.

2- Përdorimi i misvakut dhe larja e dhëmbëve me furçë.

3- Shpëlarja e gojës dhe e hundës për abdes dhe larja e trupit.

4- Hixhameja (nxjerrja e gjakut me kupa) dhe dhënia e gjakut për analiza.

5- Ejakulimi në gjumë.

6- Agjërimi nuk prishet nëse agjëruesi provon shijen e gjellës (pa e gëlltitur atë), apo i merr erë parfumit.

7- Agjërimi nuk prishet nëse përdor ilaçe me pika në vesh apo në sy (edhe nëse e ndjen shijen e ilaçit në fyt), si dhe nuk prishet nga vendosja e ilaçit mbi plagë.

8- Agjërimi nuk prishet nëse përdor ilaçe nga anusi apo organi gjenital, qoftë kjo për temperaturë apo për arsye tjetër.

9- Përdorimi i makjazhit dhe lyerja e syve nuk e prishin agjërimin.

10- Agjëruesit i lejohet të bëjë çdo gjë që i lehtëson agjërimin, si psh: qëndrimi në hije, larja e trupit apo e disa pjesëve të tij me ujë të ftohtë, shpëlarja e gojës etj.

CILAT JANË KATEGORITË E PËRJASHTUARA NGA AGJËRIMI I RAMAZANIT ?

1. Të moshuarit, të cilët për shkak të moshës nuk e përballojnë dot agjërimin.
2. Gratë shtatzëna dhe ato që i ushqejnë foshnjet me qumësht gjiri.
3. Të sëmurët (derisa të shërohen) .
4. Udhëtarët (për aq kohë sa janë në udhëtim).

Kompensimi i agjërimit, zëvendësimi i ditëve të lëna mangët dhe shlyerja e asaj dite e cila është prishur për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime.

1- Kompensimi bëhet duke ushqyer një të varfër (me ushqim mesatar) kundrejt çdo dite të Ramazanit e cila nuk është agjëruar. Kështu veprojnë të moshuarit të cilët nuk janë në gjendje ta përballojnë agjërimin, të sëmurët kronikë të cilëve mjeku ua ka ndaluar agjërimin, gratë shtatzëna, si dhe nënat të cilat ushqejnë foshnjat me qumësht gjiri. Të gjitha kategoritë e sipërpërmendura mund të mjaftohen me kompensimin me ushqim dhe nuk agjërojnë.

2- Zëvendësimi duke agjëruar ditë të tjera pas Ramazanit. Kjo dispozitë është e vlefshme për të sëmurët, udhëtarët, gratë me perioda apo në lehoni, të cilët kanë lënë mangët prej ditëve të Ramazanit. Gjithashtu gratë shtatzëna dhe gjidhënëset, nëse nuk e kanë kompensuar me ushqim.

3- Prishja e agjërimit të Ramazanit për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime. Kjo konsiderohet shkelje (mëkat) dhe shlyerja e këtij mëkati bëhet duke u penduar dhe duke agjëruar dy muaj rresht pa ndërprerje.

PËRCJELLJA E RAMAZANIT

Ramazani mbyllet me dhënien e sadakasë së Fitrit, e cila është pastrim për agjëruesin dhe ndihmë për të varfrin. Ibn Abasi ka thënë: **"Profeti ﷺ e ka bërë obligim për çdo musliman sadakanë e Fitrit si pastrim për agjëruesin prej punëve të kota dhe fjalëve të ndyra, si dhe ushqim për të varfërit. Kush e jep atë para namazit të Bajramit, ajo është sadaka Fitri e pranuar, e kush e jep pas namazit, është sadaka e thjeshtë."**

(Transmeton Ebu Daudi. Neueuiu e ka konsideruar hasen)

Më pas vjen festa e Fitër Bajramit, si gëzim për mirësitë që Allahu i Madhëruar i dhuroi muslimanëve gjatë muajit Ramazan.

Enes bin Maliku tregon se, kur Profeti (alejhi selam) mbërriti në Medinë, banorët e saj kishin dy ditë në të cilat gëzonin e dëfrenin. Profeti ﷺ pyeti: **"Përse i festoni këto ditë ?" Ata i thanë: Nga moti ne i kemi konsideruar këto dy ditë, si ditë feste. Profeti (a.s) tha: "Allahu ua ka zëvendësuar ato me dy ditë me të mira: Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin".** (Transmeton Ahmedi, Ebu Daudi dhe Nesaiu)

MUAJI I RAMAZANIT, FTESË PËR PENDIM...

O njeri! Çfarë fitove duke qëndruar larg Zotit tënd? Ramazani erdhi, flladi i besimit po fryn dhe mëshira e Allahut është shumë pranë teje, prandaj kthehu tek Allahu!

Kthehu me vullnet dhe pendim, sa nuk je kthyer i mbartur mbi supe e i veshur me qefin!

Dera e pendimit është e hapur, hyrja është e lejuar, prandaj kthehu tek Zoti, që të kënaqet me ty dhe të të falë mëkatet e tua!

Afrohu tek Allahu, që të t`i kthejë të këqijat në të mira dhe të shkruhesh në listën e atyre që Allahu i do: **"Vërtet Allahu i do ata që pendohen."** (Kuran, El Bekarah 222)

Mëshira e Allahut ka përfshirë gjithçka dhe Ai e shkroi këtë në librin e Tij: **"Mëshira Ime e tejkalon hidhërimin Tim."** (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

A e ke dëgjuar ndonjëherë këtë ajet, ku Zoti të thërret duke të thënë: **"O robërit e Mi, që i keni bërë vetes keq me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Patjetër që Allahu i fal të gjitha gjynahet! Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti."** (Kuran, Zumer 53)

Eja, afrohu tek Allahu, sepse Ai mëshiron dhe fal! **“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”** (Kuran, Taha 82).

Pendohu nga të këqijat që ke punuar dhe zotohu që kurrë nuk do t`u kthehesh atyre veprave të shëmtuara!

Shfrytëzoje këtë muaj për të hapur një faqe të re, mbi të cilën do të shkruash:

O Zot, unë jam penduar!

BES
w w w . u d h a e b e s

dha e SIMTARËVE

simtarëve.com





FLLADI I NJË MUAJI TË BEGATË

Udha e BESIMTARËVE

www. udhaebesimtareve.com

JEPET FALAS